

**KËRKESA TË PËRGJITHSHME**

- Duhet të jepni dëshmi të datës së lindjes dhe emrit tuaj.
- Dokumentet që dorëzoni për të dëshmuar emrin tuaj duhet të kenë një vlerë totale prej 6 pikësh.

*Një leje drejtimi për drejtues automjeti me foto nga shteti i Nju Jorkut, leja e praktikantit ose karta e identitetit të jodrejtuesit e shtetit të Nju Jorkut që është e vlefshme, ose që nuk ka më shumë se 2 vjet që ka skaduar, janë objekt i kërkesave të dëshmisë së emrit dhe datëlindjes. Referojuni tabelës më poshtë për listën e dokumenteve të tjera që mund të jepni për të dëshmuar datëlindjen dhe emrin tuaj.*

Duhet të jepni dokumentet origjinale ose dokumentet që janë të certifikuar nga agjencia lëshuese. Nënshkrimi juaj duhet të jetë në të paktën një nga dokumentet që tregoni për dëshmi. DMV-ja nuk do të pranojë dokumente me ndryshime apo fshirje. Pasqyrat elektronike dhe faturat elektronike duhet të printohen.

Nëse dërgoni një person në DMV për të depozituar kërkesën tuaj për regjistrimin ose titullin e pronësisë, ky person **duhet** të vendosë në dispozicion lejen e tij/saj origjinale të drejtimin me foto, lejen, ose kartën e identitetit të lëshuar nga shteti i Nju Jorkut **dhe** një fotokopje të licencës, lejes ose kartës së identitetit të lëshuar së fundi nga shteti i Nju Jorkut.

<b>DOKUMENTET E PRANUESHME SI DËSHMI E IDENTITETIT PËR REGJISTRIMIN DHE TITULLIN E PRONËSISË</b>	<b>DËSHMI E EMRIT PIKËT VLERA</b>	<b>DËSHMI E DATËLINDJES?</b>
Dokumentet e skaduara nuk pranohen, përveç se kur është shënuar në mënyrë specifike në tabelën e mëposhtme.		
<b>Leje drejtimi me foto e shtetit të Nju Jorkut/Leje për praktikantë/Kartë identiteti të jodrejtuesit.</b> Duhet të jetë e vlefshme ose të mos ketë më shumë se 2 vjet që ka skaduar.	<b>6</b>	<b>PO</b>
Deklaratë e DMV-së e identitetit dhe/ose deklarata e vendbanimit nga prindi/kujdestari (MV-45) - NËSE JENI NËN 21 VJEÇ. Deklaratë nga prindi ose kujdestari ligjor, nënshkruar në prani të një përfaqësuesi të DMV-së. Referojuni MV-45 për më shumë informacion.	<b>6</b>	<b>JO</b>
Deklaratë e DMV-së e identitetit dhe/ose e vendbanimit - Për aplikantët e përfaqësuar nga qeveria ose institucionet e miratuara nga qeveria (MV-45A). Referojuni MV-45A për më shumë informacion.	<b>6</b>	<b>JO</b>
Dëshmi e themelimit, dëshmi e ortakërisë, faturë e depozitimit të DBA-së (Referojuni MV-82.1 për detaje).	<b>6</b>	<b>JO</b>
Pasaportë e huaj me vulë të vlefshme I-551 ose me deklaratë në vizë. Pasaporta duhet të jetë në anglisht ose e përkthyer nga një ambasadë.	<b>4</b>	<b>PO</b>
Pasaportë e huaj me vizë amerikane dhe formular të vlefshëm I-94. Pasaporta duhet të jetë në anglisht ose e përkthyer nga një ambasadë. SHËNIM: Nëse formulari juaj I-94 ka kodin e statusit A1, A2, G1 ose G3, duhet të kontaktoni Departamentin e Shtetit për të regjistruar automjetin(-et) tuaj (-a).	<b>4</b>	<b>PO</b>
Pasaportë ose kartë pasaporte e lëshuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së. Duhet të jetë e vlefshme.	<b>4</b>	<b>PO</b>
Leje drejtimi me foto e lëshuar nga një shtet tjetër i SHBA-së, juridiksion ose autor tjetër, ose provincë ose territor kanadez. Duhet të jetë e vlefshme ose të mos ketë më shumë se 2 vite që ka skaduar.	<b>4</b>	<b>PO</b>
Kartë identiteti me foto e ushtrisë së SHBA-së (lëshuar vetëm për personelin ushtarak aktiv, rezervë dhe në pension)	<b>3</b>	<b>PO</b>
Certifikatë natyralizimi ose shtetësie (N-550, N-560, N-561, dhe N-570)	<b>3</b>	<b>PO</b>
Karton autorizimi për punë (I-688B ose I-766) me foto	<b>3</b>	<b>PO</b>
Kartë e rezidencës së përhershme (I-551)	<b>3</b>	<b>PO</b>
Leje rihyrjeje (I-327)	<b>3</b>	<b>PO</b>
Dokument udhëtimi për refugjatët (I-571)	<b>3</b>	<b>PO</b>
Kartë e përfitimeve shëndetësore/Medicaid e shtetit të Nju Jorkut ME foto	<b>3</b>	<b>JO</b>
Kartë e përfitimeve shëndetësore/Medicaid e shtetit të Nju Jorkut PA foto	<b>2</b>	<b>JO</b>
Licencë / leje e përkohshme e shtetit të Nju Jorkut PA foto	<b>2</b>	<b>JO</b>
Leje për armëmbajtje e shtetit të Nju Jorkut ose e qytetit të Nju Jorkut	<b>2</b>	<b>JO</b>
Licencë profesionale e shtetit të Nju Jorkut	<b>2</b>	<b>JO</b>

<p style="text-align: center;"><b>DOKUMENTET E PRANUESHME SI DËSHMI E IDENTITETIT PËR REGJISTRIMIN DHE TITULLIN E PRONËSISË</b></p> <p style="text-align: center;">Dokumentet e skaduar NUK pranohen, përveç nëse është shënuar në mënyrë specifike në tabelën e mëposhtme.</p>	<p style="text-align: center;"><b>DËSHMI E EMRIT PIKËT VLERA</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>DËSHMI E DATËLINDJES?</b></p>
Dokument regjistrimi i shtetit të Nju Jorkut (vetëm për automjetet ose varkat)	2	JO
Certifikatë pronësie e shtetit të Nju Jorkut	2	JO
Kartë identiteti fisnore me foto e St. Regis Mohawk	2	<b>PO</b>
Kartë identiteti e vartësve ushtarakë e SHBA-së	2	JO
Kartë identiteti me foto të kolegjit e SHBA-së dhe transkripti zyrtar	2	JO
Kartë identiteti me foto e shkollës së mesme të SHBA me kartë raporti ose transkript zyrtar	2	JO
Dokument i regjistrimit të martesave ose divorceve OSE vendim për ndryshimin e emrit të lëshuar nga gjykata e SHBA-së	2	JO
Karta e sigurimit shoqëror e SHBA-së	2	JO
Mandat pagese i printuar në kompjuter i SHBA-së (duhet të ketë emrin tuaj)	1	JO
Kartë identiteti e punonjësit e SHBA-së	1	JO
Diplomë e shkollës së mesme e SHBA-së OSE Diplomë e Ekuivalencës së Përgjithshme (GED)	1	JO
Kartë arkëtimi supermarketi e SHBA-së (duhet të ketë nënshkrimin tuaj dhe emrin e printuar paraprakisht)	1	JO
Kartë sindikate e SHBA-së	1	JO
Kartë sigurimi shëndetësor/Kartë për receta për të dhënë dëshmi aktuale të mbulimit me sigurim shëndetësor	1	JO
Policë e sigurimit të jetës (e vlefshme për të paktën 2 vjet)	1	JO
Faturë shërbimi me emrin dhe adresën. Fatura e shërbimeve përkufizohet si një faturë që përmban emrin dhe adresën e aplikantit për çdo shërbim të përsëritur (p.sh. fatura e telefonit fiks ose celular, fatura e energjisë elektrike, fatura e mbeturinave, fatura e ujit.) Mund të pranohet vetëm një faturë shërbimi për aplikant.	1	JO
Kartë identiteti me foto e Aksesit Universal të Veteranëve	1	JO
Tatimi mbi të ardhurat federale ose të shtetit të Nju Jorkut W-2	1	JO
Mund të depozitohet vetëm <b>një</b> nga zërat e mëposhtëm, nëse është lëshuar nga <b>i njëjti</b> institucion financiar: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjendje e llogarisë bankare</li> <li>• Çek i anuluar (me emrin tuaj të printuar paraprakisht)</li> <li>• Kartë debiti (ATM) (duhet të ketë emrin dhe nënshkrimin tuaj të printuar paraprakisht)</li> <li>• Kartë krediti kryesore e vlefshme</li> </ul>	1	JO
Kartë identiteti me foto e bashkisë e SHBA-së	1	JO
Kopje origjinale ose e certifikuar e Raportit Konsullor të SHBA-së për Lindjet Jashtë Vendit (FS-240, DS-1350, F-545)	0	<b>PO</b>
Certifikatë lindjeje e SHBA-së (lëshuar nga një shtet ose qeveri lokale)	0	<b>PO</b>
Certifikatë lindjeje kanadeze me leje praktikanti të DMV-së kanadeze ose kartë identiteti e jodrejtuesit	0	<b>PO</b>
Pasaportë e vlefshme kanadeze (pa dokumentacion INS)	0	<b>PO</b>
Certifikatë lindjeje fisnore nga një fis i njohur në nivel federal, për të vërtetuar lindjen në SHBA	0	<b>PO</b>

**VINI RE:** Nëse bëni një deklaram të rremë, ose depozitoni ndonjë dokument të rremë, mund të dënoheni për vepër penale.

DMV-ja nuk do të pranojë asnjë dokument të dëmtuar ose të shkatërruar, ose dokument me ndryshime apo fshirje. DMV-ja do të konfiskojë çdo dokument që duket si i rremë. Nëse depozitoni një dokument të rremë, mund t'i nënshtroheni ndjekjes penale.